



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the General Secretary

Nr. 81 /2026
Datë: 07/07/2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 03/ L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me plotësim ndryshimet përkatëse dhe Ligjit Nr. 06/ L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, në përputhje me nenin 44 dhe 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me dispozitat relevante të Rregullores Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike dhe Rregullores së MF-së Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo-financiare, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/ 2009 për delegimin e Menaxhimit të Shpenzimeve në organizatat buxhetore, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Samire Shabani - Berisha, Zyrtare e Lartë për Buxhet në Divizionin për Planifikimin dhe Monitorimin e Buxhetit në Departamentin për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Drejtësisë, ngarkohet të kryejë edhe punë shtesë si Zyrtare e Pasurisë jo financiare për Ministrinë e Drejtësisë.
2. Zyrtarja e caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi obligohet të regjistrojë në mënyrë të rregullt të gjitha pasuritë me vlerë mbi një mijë (1,000) euro në SIMFK, si dhe pasuritë nën një mijë (1,000) euro në regjistrat kontabël (e-pasuria), bazuar në faturat dhe fletëpranimet përkatëse, si dhe të kryej detyrat dhe përgjegjësitë e saj sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Me këtë vendim, shfuqizohet vendimi Nr.83/2025 i datës 10.06.2025.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në bazë të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për plotësimin e pozitës së zyrtarit për regjistrimin e pasurisë jo financiare, si dhe me qëllim të përmirësimit të menaxhimit dhe evidentimit të pasurisë në institucion, është vlerësuar e nevojshme ndërmarrja e masave të përkohshme organizative deri në rekrutimin e rregullt të kësaj pozite.

Duke marrë parasysh se procedurat e rekrutimit kërkojnë kohë për t'u zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe për të shmangur vonesat apo mangësitë në regjistrimin dhe menaxhimin

e pasurisë jo financiare, është konsideruar e arsyeshme që kjo detyrë të mbulohet përkohësisht, andaj u vendos si ne dispozitiv të këtij vendimi.



Ridvan Hoti

Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj. Samire Shabani Berisha;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Departamentit për Shërbime të Përgjithshme;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore dhe*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*